

SHQIPËRIA SIPAS BURIMEVE POLAKE 1918-1944

(Donika Avdulli, *Shqipëria sipas burimeve polake 1918-1944*,
Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë 2024)

Monografia e autores Donika Avdulli, “*Shqipëria sipas burimeve polake 1918-1944*”, është një përmbledhje ligjëruese e të dhënave arkivore me proveniencë polake në lidhje me shqiptarët dhe Shqipërinë. Për nga struktura kronologjike, autorja i ka qëndruar besnike ndarjeve sipas ngjarjeve madhore historike në kontekst evropian dhe në këtë formë i ka ndërlidhur burimet e vjela vis-a-vis interesit të opinionit polak mbi zhvillimet në Shqipëri. Monografia është e ndarë në 5 kapituj kryesorë, të nënndara në një numër nënkapitujsh me tërësi 265 faqe, pa përfshirë treguesin e emrave. Kapitulli i parë titullohet “*Shqipëria në përfundim të Luftës së Parë Botërore sipas burimeve polake*”, kapitulli i dytë vazhdon me “*Shqipëria në Lidhjen e Kombeve në raportet e diplomatëve polakë*”, kapitulli i tretë “*Fillimi i konsolidimit të shtetit shqiptar në planin e brendshëm dhe ndërkombëtar*”, kapitulli i katërt “*Mbretëria Shqiptare 1928-1939 sipas burimeve polake*” dhe kapitulli i pestë dhe i fundit, i titulluar “*Shqipëria gjatë viteve 1939-1945 sipas burimeve polake*”. Në monografinë e saj, autorja ka shfaqur një metodikë të patëmetë në përmbledhjen e burimeve, duke lëvruar një varietet publikimesh që nga gazetate ditore, periodiket dhe trajtesat etnografike dhe historike, duke përfshirë edhe disa fotografi e faksimile dokumentesh. Me shumë interes për historiografinë shqiptare, duke qenë se monografia përmban pasqyrë të proveniencës së pakprekur deri më tash, atë polake, është fakti që këtu kemi pikëpamje mbi jetën e përditshme shqiptare, po aq sa kemi edhe për rrjedhat e politikës për Shqipërinë e brenda Shqipërisë. Kjo qasje i ofron lexuesit një tablo të historisë së përgjithshme, duke e përfruar atë me përditshmërinë shqiptare, por pa e shkëputur këtë përditshmëri nga fati politik i Shqipërisë - që shpeshherë ishte në udhëheqje e produkt i vendimmarrjes së forcave të jashtme - fakt, ky, që autorja nuk nguron ta theksojë disa herë përgjatë monografisë. Me interes të posaçëm janë edhe raportimet e palës polake për zhvillimet në Lidhjen e Kombeve, posaçërisht duke qenë se ata mund të konsiderohen si vëzhgues neutralë pa ndonjë interes të drejtpërdrejtë në Shqipëri. Strukturimi

i këtij kapitulli, në veçanti, është i atillë që i ofron lexuesit një këndvështrim të gjithmbarshëm për rendin e ri botëror, pa iu nënshtuar klisheve historike të ligjërit. Përderisa në zhvillime politike është gjithherë vështirë të flitet me terma absolute, në trajtimin e këtij kapitulli e shohim një qasje dekonstruktive të realitetit objektiv gjeopolitik dhe ndërthurjes së saj me interesa ndërkombëtare për paqe dhe stabilitet universal. Si shembull, denoncimi i Alfred Hlapovskit, ambasador i Polonisë në Paris, në lidhje me jokonsistencën e Francës në raport me Shqipërinë dhe ndikimet strategjike të Jugosllavisë mbi Francën për çështjen e Shqipërisë, janë po ashtu burim i rëndësishëm historiografik, meqë flet për zhvillim të një vetëdijesimi demokratik ndërkombëtar të periudhës në fjalë. Ai e denoncon edhe Italinë për ndikim të pabarabartë financiar mbi Shqipërinë.

Të dhëna faktike të detajuara jepen edhe për periudhën e Luftës së Dytë Botërore, por që në disa raste nuk është shumë e qartë nëse provenienca është amerikane dhe dokumentet janë të përkthyer dhe arkivuara në polonisht.

Qasja e autores së trajtimit nga veta e parë është freskuese dhe e paraqet një relaksim të raporteve ndërmjet lexuesit dhe autores - një dimension që i mungon shumë trajtesave historiografike bashkëkohore dhe kjo gjë e bën tekstin të jetë ftues për lexuesin.

Mrika LIMANI-MYRTAJ